



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-87805

Data: 02. 09. 2025

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Drejtoria e Sherbimeve Publike – KK Prizren me seli në rrugën Remzi Ademaj,** me të cilën pala ka kërkuar leje për: **ndërtimin - shtruarjen e rrugës – Wiliam Walker** e në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 të Ligjit për Planifikimit Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt. 31. 07. 2013, nenit 3.1.1, 1.2, 1.4, 1.17, 1.24, e në lidhje me nenin 4, 1.2, si dhe nenit 5, 1.1 e lidhur me nenin 14.1.4, të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, si dhe konform nenit 40 alinea 4 dhe nenit 41 alinea 1, dhe të nenit 45 e lidhur me nenin 51, dhe sipas konform Vendimit për miratimin e sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt. 31. 03. 2022 dhe në harmoni me dispozitat 3. alenia 1 pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.5, dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. 83 e në lidhje me nenin 84. 85. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET - : Drejtoria e Sherbimeve Publike – KK Prizren me seli në rrugën Remzi Ademaj, me të cilën pala ka kërkuar leje për: **ndërtimin - shtruarjen e rrugës – Wiliam Walker (sipas projektit të prezantuar N.SH."ARCHANGE")** në pjesën e ngastrave kadastrale me nr. 07113-1, 07113-7, 07113-8 dhe 07115-1 Z. K. Prizren si:

- Shtrese nga Asfaltbetoni 0/16 5.0cm
- Shtrese nga bituagregati 0/22 8.0cm
- Shtrese mbrojtëse prej ngricave 0/32 10.0cm
- Shtrese mbrojtëse prej ngricave 0/63 20.0cm

- I. Dokumentacioni teknik e mban titullin e veçantë-Projekti detal I punuar nga Byroja projektuese **N.SH."ARCHANGE"** me seli në rrugën "Xhevë Lladrovci" pn.
- II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektoriatin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III. Hunjëzimi i rrugës të bëhet sipas dokumentacioni teknik.
- IV. Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime
- V. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbëdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës

- VII. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VIII. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- IX. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkojë nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.
- X. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.
- XI. Në rast të paraqitjes së pengesave pronësore gjate implementimit të projektit me pronarë eventual – të njëjtat do të zgjidhen nga Drejtoria e Sherbimeve Publike

P.S. Investitori është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, si dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

A r s y e t i m

Drejtoria e Sherbimeve Publike-investitor Komuna e Prizrenit, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për : **ndërtimin - shtruarjen e rrugës** – Wiliam Walker. Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionin teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:


Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për : **ndërtimin - shtruarjen e rrugës – Wiliam Walker**.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI së-Prishtinë.

Bashkëpunëtorë profesionalë:


Ylber Gashi, inxh. dip. ark.



DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur. dip.